



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Data 24.02.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**Objekti i prokurimit: Studim Projektim Vendosje e paneleve kundër ndotjes akustike në
zonat e banuara - Unaza e Madhe**

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit: **(CPV): 71000000-8** (Shërbime
arkitektonike, inxhinierike, ndertimi dhe inspektimi)

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **3,324,240** (tre milion e treqind e njëzet e katër mijë e
dyqind e dyzet) lekë pa TVSH

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 të LPP, Nenit 26, të VKM Nr.
285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i
vetëdeklarimit” dhe Neni 82, i LPP “162”. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose
të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa
vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të
vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari pëcaktohet në
rregullat e prokurimit publik”.

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*” i ndryshuar.

2.2.2. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3KapacitetiTeknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte ku të shënohet vlera, afati i kontratës dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, të realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte së realizuar.

c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

d) Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi mbikqyrje për të deshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

2-d Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

3.c1 Objekte me shkallë të lartë vështirësie beton armë

4. PROJEKTUES INSTALATOR

4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

4.f Sisteme kundër zjarrit

6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

6.a Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytesore dhe rrugë interurbane dytesore

6.b Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore

8. PROJEKTUES GJEODET

8.a Rivëlme inxhinierike.

8.c Sisteme GIS.

8.d Bazamente gjeodezike

8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK

9.e Studime e Projektme hidrogeologjike

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

10.e Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.

11.a Sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytesore, rrugë interurbane dytesore, sheshe parkime.

11.b Projektim sinjalistike jondricuese në autostradë, rrugë urbane dhe rrugë interurbane kryesore dhe degezime me hekurudhë.

11.d Projektim sinjalistike ndricuese

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

12.c Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në

ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studimit projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
PROJEKTU ES ARKITEKT	2 d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi arkitekt eshte kerkuar ne funksion te shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e barrierave dhe raportit me projektin me peisazhin ku kalon ky i fundit.</i>
PROJEKTU ES KONSTRUKTOR	3.c 1 Objekte me shkalle te larte veshtiresie beton arme	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi konstruktor do te jete i domosdoshem për projektimin e veprave inxhinierike, ndërtimit dhe strukturave me kapacitet mbajtës pasi pritët te realizohen ne funksion te qëllimit te projektit.</i>
PROJEKTU ES INSTALATOR	4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. 4.f Sisteme kundra zjarrit	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi instalator do te jete per instalimin e ri elektrik ,të parashikojë ndricimin, vendosja e gabine elektrike nëse është e nevojshme ,ndricim i emergjencës dhe sigurisë etj</i> <i>Të parashikohet projekti i mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standarteve europiane.</i>

PROJEKTU ES RRUGE - HEKURUD HA	6.a Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore 6.b Projektim rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi i rrugëve sipas kategorive perkatese do te jete per projektimin e veprave te barriareve ne rrugen kryesore si dhe ne rruget e aksesit ne kete rruge. Nderlidhja me rruget dytesore.</i>
PROJEKTU ES GJEODET	8.a Rivelimet inxhinierike. 8.c Sisteme GIS. 8.d Bazamente gjeodezike 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik	<i>Projektuesi gjeodet do te realizoje rileveimet e veprave inxhinierike ekzistuese dhe pozicionimin e infrastruktures se re. Te gjithë kategorite jane e funksion te realizimit te ketij procesi pune.</i>
STUDIM GJEOLLO- O- INXHINIER IK – HIDROGJE OLOGJIK	9.e Studime e Projektme hidrogjeologjike	<i>Studim dhe vleresim gjeologjik per realizimin e strukturave mbeshtese ne funksion te projektit (mure mbajtese, pilota etj) Studim gjeologjik per zona te caktuara ku ndertohen struktura ndihmese me qellim realizimin e barriareve mbrojtese ne truall kodrinor jo te banuar me relief te ndryshem.</i>
PROJEKTI MI I IMPIANTE VE TË PRODHIMI T DHE SHPËRNDAR RJES SË ENERGJIS Ë ELEKTRIK E	10.e Kabina elektrike te rrjetit shperndares – linja te tensionit te ulet – te mesem	<i>Sipas percaktimeve te detyres se projektimit kerkohet qe ne projekt te pasqyrohen te gjithë linjat ekzistuese duke mare ne konsiderate ineterferencen dhe zgjidhjen ne funksion te ketij projekti</i>
PROJEKTU ES TË SINJALIZI MIT RRUGOR	11.a Sinjalistike jondricuese ne rruge lokale, rruge urbane dytesore, rruge interurbane dytesore, sheshe parkime. 11.b Projektim sinjalistike jondricuese ne autostrada, rruge urbane dhe rruge	<i>Sinjalistika rrugore e shtrire dhe vertikale. Vije- zimet, tabelat e indikacionit etj ne rruge lokale, urbane dytesore, sheshe e parkime.</i> <i>Sinjalistika rrugore e shtrire dhe vertikale. Vije- zimet, tabelat e indikacionit etj ne rruge urbane kryesore, degezime etj.</i>

	interurbane kryesore dhe degezime me hekurudhen. 11.d Projektim sinjalistike ndricuese	<i>Sistemet e Semaforeve, integrimi i rrugekalimeve ne to.</i>
STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE	12.c Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndertohen objekte te infrastruktures rrugore dhe hekurudhore te te gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.	<i>Projektimi i veprimit dinamik (sizmik) mbi strukturat mbajtese ne funksion te qellimit te realizimit te vepres.</i>

2.3.3 Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklarate listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajte e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumin 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për minimumin për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kerkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Detyres së Projektimit. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregojnë besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve*

është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesiper perkon me stafin qe pritet te jete I angazhuar ne keto procedura.

2.3.5 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Infrastruktura
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik/Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Mjedis
- 1 (një) Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizik
- 1 (një) Arkitekt

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme", operatorët pjesëmarrës duhet të deklarojnë për stafin e kërkuar sipas pikës 2.3.5, të dhënat si më poshtë:

Emër / Mbiemër

Profilin e punës

Numrin dhe datën e kontratës individuale të punës

Numrin e licensës individuale profesionale në projektim

Numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen. Pika e licensës me sipër perkojnë përkatësisht me stafin drejtues teknik për realizimin e procedurës.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- Ekspert për PMNZSH (duhet të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Brendshme sipas ligjit në fuqi)
- 1(nje) Ing. Gjeoteknik
- 1(nje) Ing. Profili Infrastruktura transporti
- 1(nje)Ing. Profili Strukturist

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, të paktën njëri nga operatorët duhet të ketë pjesë të stafit të tij një specialist në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin).

Shenim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 2.3.6, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

a) Për stafin e mësipërm Operatori ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme)
- Diplomë / Certifikatë (e vlefshme)

b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B "*Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme*", operatorët pjesëmarrës si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për stafin e kërkuar sipas pikës 2.3.6 të dhënat si më poshtë:

- Emër / Mbiemër
- Profilin e punës
- Numrin dhe datën e kontratës individuale të punës
- Numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën / certifikatën përkatëse si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Prezenca e stafit të mësipërm është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.

- 1 (një) pajisje Droni per realizimin e punimeve te fotogrametrise.
- 1 (nje) aparat mates per nivelin e zerit te klasit I-re,i kalibrueshem sipas standartit - ISO 17025, i cili do te kryejë matjet ne perputhje me standartet IEC 61672 ose ANSI S1.4.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertues i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndersa operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes të kontretes, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise,ose standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent

ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalent

ISO 45001-2018 (e vlefshme)/ose/ekuivalent Për sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune.

ISO 50001:2018 (e vlefshme)/ose/ekuivalent Për sistemin e Menaxhimit të Energjiise.

ISO 39001-2012 ose ekuivalente

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Kërkesat e mesipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

Shënim: *Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhurnuar.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve të cilat është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fituesit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.